

Më 18-06-2018
Dana

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:013690
Datë: 30.04.2018
Numri i dokumentit: 00032091

P.nr.317/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal- në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2562-2/2014 të datës 13.05.2015, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2562-2/2014 të datës 13.05.2015 për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 30.04.2018 mori:

AKTGJYKIM

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj 2562-2/2014 të datës 13.05.2015, gjykata jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga babai [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, I gjendjes së varfër sociale, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 13.10.2014 rreth ores 10:30 në pyllin publik në vendin e quajtur "Jezerc paralelja 65" në Rajonin e Ekonomisë Pyjore, Nerodime –Jezerc i pandehuri është takuar duke prerë 2(dy) copë trugu-dru të ahut të njom, me diameter 47-50 cm, me vëllim të përgjithshëm 3.45 metra kub, të cilat i ka prerë me sharrë motorike dhe i ka bartur me traktor në vlerën e dëmit të shkaktuar prej 465.75 euro,

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

GJYKON

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 euro (me shkronja dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasuroro-juridike të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj të i kopmensoj dëmin e shkaktuar të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shmën prej 465.75.00 Euro (me shkronja: katërqind e gjashtdhjetë e pesë euro e shtatdhjetë e pesë cent) në afat prej 15 dite nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 2562-2/2014 të datës 13.07.2015 ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, e njëjtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 2562-2/14 të datës 13.07.2015 me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Fletëparaqitjen e Rojës së Pyllit të DBPZH-APK-Zyra në Ferizaj 93/2014 e dates 20.10.2014, si dhe Procesverbali nga Komisioni i Ekspertëve për vlerësimin e demit DBP-Zyra në Ferizaj me numër të njejtë 93/2014 dt. 20.10.2014, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit dënimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 458-460 të KPPRK-së, i pandehuri në emër të kërkesës pasuroro-juridike për kompensimin e demit të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, pylltari-Zyra në Ferizaj obligohet që të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi prej 465.75 euro.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P nr.317/18, datë 30.04.2018

Zyr.ligjor

Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,

Elmaz Zenuni



Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ndërkaq, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nga një kopje u dërgohet PTH-së dhe të dëmtuarit.